



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 337/prot.
1

Tiranë, më 26.03.2025

VENDIM

Nr. 1172 , Datë 26.03 . 2025

“MBI MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2024 DHE PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2025”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.03.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024 dhe prioritetet kryesore për vitin 2025.

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja d) dhe e), neni 26 dhe neni 29, pika 2, shkronja ç) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024 dhe prioritetet kryesore për vitin 2025.” dhe draft raportin e përgatitur nga Sekretariati,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 29, pika 2, shkronja ç të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka hartuar draft raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024 dhe prioritetet kryesore për vitin 2025.

Raporti është i strukturuar në 7 seksione, sipas formatit të kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:




Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 shkronja d) dhe e) dhe nenit 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024 dhe prioritetet kryesore për vitin 2025”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA () Zv/Kryetar	Rezana KONOMI () Anëtar	Durim KRAJA () Anëtar	Fatjola DELIJA () Anëtar
Denar BIBA () Kryetar 			